



## VENDIM

*Nr.57 Datë 29.05.2013*

### PËR FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË “SNOW ENERGY” SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “a”; 9, dhe nenit 45 pikat “3” dhe “4”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f” dhe 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pikat 1, gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29 .05.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SNOW ENERGY” sh.p.k”, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

#### **Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “SNOW ENERGY” sh.p.k” plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**  
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “SNOW ENERGY” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**